



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2023-12/IA008

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Emilio Gati  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 5 dhjetor 2025

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Apelin e Fadil Fazliut kundër Vendimit të Pestë mbi Rishikimin e  
Paraburgimit**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit:**  
Sofi Menegon

**Mbrojtjes së Bashkim Smakajt**  
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtjes së Isni Kilajt:**  
Ian Eduards

**Mbrojtjes së Fadil Fazliut**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Hajredin Kuçit:**  
Aleksandër Admiral

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, "Paneli i Gjykatës së Apelit", "Paneli i Apelit" ose "Paneli" dhe "Dhomat e Specializuara"),<sup>1</sup> në zbatim të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja") ka marrë në shqyrtim apelin e dorëzuar më 15 tetor 2025 nga z. Fadil Fazliu (përkatësisht, "Apeli" dhe "Fazliu" ose "i akuzuari"),<sup>2</sup> kundër Vendimit mbi Apelin e Fadil Fazliut kundër Vendimit të Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut ("Vendimi i Kundërshtuar").<sup>3</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") u përgjigj më 27 tetor 2025 se Apeli duhet të hidhet poshtë ("Përgjigjja").<sup>4</sup> Fazliu u kundërpërgjigj më 3 nëntor 2025 ("Kundërpërgjigjja").<sup>5</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Fadil Fazliu u arrestua në Kosovë<sup>6</sup>, në bazë të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake<sup>7</sup>, dhe në vijim të konfirmimit të aktakuzës kundër tij, z. Hashim Thaçi ("z. Thaçi"), z. Bashkim Smakaj, z. Isni Kilaj dhe z. Hajredin Kuçi ("Vendimi i Konfirmimit")<sup>8</sup>

---

<sup>1</sup> IA008/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 17 tetor 2025 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 3 dhjetor 2025).

<sup>2</sup> IA008/F00001, Apeli i Fazliut kundër Vendimit të Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit, 15 tetor 2025 (konfidencial) ("Apeli"). Shih gjithashtu IA008/F00001/A01, Shtojca 1 e Apelit të Fazliut Kundër Vendimit të Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit, 15 tetor 2025 (konfidencial) ("Shtojca e Apelit").

<sup>3</sup> F00479, Vendimi i Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut, 3 tetor 2025 ("Vendimi i Kundërshtuar").

<sup>4</sup> IA008/F00003, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Fazliut kundër Vendimit mbi Rishikimin e Pestë të Paraburgimi, 27 tetor 2025 (konfidenciale) ("Përgjigjja"), para. 2, 23.

<sup>5</sup> F00005, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Fazliut, 3 nëntor 2025 (konfidenciale) ("Kundërpërgjigjja").

<sup>6</sup> F00045, Njoftim i Arrestimit të Fadil Fazliut sipas rregullës 55(4), 5 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe ex parte, riklasifikuar si publik më 14 janar 2025).

<sup>7</sup> F00037/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse, 19 dhjetor 2024 (versioni rreptësisht konfidencial dhe ex parte u dorëzua më 29 nëntor 2024, u riklasifikua si konfidencial më 6 dhjetor 2024) ("Vendimi mbi Arrestimin").

<sup>8</sup> F00036/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 12 shkurt 2025 (versioni rreptësisht konfidencial dhe ex parte u dorëzua më 29 nëntor 2024, dhe u riklasifikua si konfidencial më 13 dhjetor 2024) ("Vendimi i Konfirmimit"). Më 2 dhjetor 2024, ZPS-ja dorëzoi

2. Më 8 dhjetor 2024, në paraqitjen e parë të z. Fazliu,<sup>9</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij.<sup>10</sup>
3. Gjykatësja e Procedurës Paraprake më pas rishikoi dhe vazhdoi paraburgimin e Fazliut çdo dy muaj deri në fazën aktuale.<sup>11</sup>
4. Më 3 tetor 2025, pasi mori parashtrime nga Palët,<sup>12</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Kundërshtuar, ku urdhëroi vazhdimin e paraburgimit, ndër të tjera, mbi bazën se: (i) ekziston dyshimi i bazuar se z. Fazliu ka kryer vepra penale që përfshihen në juridiksionin lëndor të Dhomave të Specializuara, konkretisht tentim për të penguar persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe mosbindje ndaj gjykatës brenda kuptimit të neneve 401(2) dhe (5), dhe 393 të Kodit Penal të

---

aktakuzën e konfirmuar. Shih F00055, Parashtrim i Versionit të Redaktuar Publik i Aktakuzës së Konfirmuar, 6 dhjetor 2024, publik. F00040/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar, 6 dhjetor 2024 ("Aktakuza e Konfirmuar"). Shih gjithashtu F00040, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar, 2 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si rreptësisht konfidencial më 3 dhjetor 2024, u riklasifikua si konfidencial më 12 nëntor 2025); F00040/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, 2 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si rreptësisht konfidencial më 3 dhjetor 2024, u riklasifikua si konfidencial më 12 nëntor 2025). Më 14 prill 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndryshoi Vendimin e Konfirmimit, por ndryshimet nuk kishin të bënin me Fazliun. Shih F00260, Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Parashtrimin e Mocioneve Paraprake, 14 prill 2025. Më 16 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar. Shih F00264, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, 16 prill 2025; F00264/A02, Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, 16 prill 2025 ("Aktakuza e Konfirmuar a Ndryshuar").

<sup>9</sup> Transkripti, 8 dhjetor 2024, f. 45-69.

<sup>10</sup> Transkripti, 8 dhjetor 2024, f. 65-69.

<sup>11</sup> F00163, Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut, 7 shkurt 2025 ("Vendimi i Parë i Rishikimit"); F00251/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut, 7 prill 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 7 prill 2025) ("Vendimi i Dytë i Rishikimit"); F00327, Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut, 5 qershor 2025, ("Vendimi i Tretë i Rishikimit") F00404, Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut, 5 gusht 2025 ("Vendimi i Katërt i Rishikimit").

<sup>12</sup> F00428/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut në lidhje me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit, 4 shtator 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 gusht 2025) ("Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake"); F00447/RED, Version i Redaktuar Publik i Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut në lidhje me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit, 15 shtator 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 10 shtator 2025) ("Përgjigjja e ZPS-së ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes"); F00452, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Fazliut ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj F00428, 15 shtator 2025 (konfidenciale, e riklasifikuar si publike më 10 dhjetor 2025) ("Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së ZPS-së").

Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074, përkatësisht, në shkelje të nenit 15(2) të Ligjit, dhe (ii) vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Fazliu të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit të Dhomave të Specializuara ose të kryejë vepra penale të tjera.<sup>13</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu konstatoi se asnjë prej kushteve për lirim të përkohshëm të propozuara prej Fazliut, dhe as kushte të tjera të arsyeshme të caktuara nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.<sup>14</sup>

5. Më 12 nëntor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Gjykatësit të Vetëm.<sup>15</sup>

6. Më 24 nëntor 2025, Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesën e Fazliut për zgjatje të afatit për t'u përgjigjur ndaj parashtrimeve të ZPS-së në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të tij deri pas vendimit të Panelit mbi Apelin.<sup>16</sup> Më 28 nëntor 2025, Fazliu dorëzoi një njoftim për heqje dorë nga e drejta për rishikim të paraburgimit deri në lëshimin e vendimit aktual.<sup>17</sup> Më 2 dhjetor 2025, Mbrojtja njoftoi Gjykatësin e Vetëm se Fazliu kishte ndërmend të tërhiqte njoftimin për heqje dorë nga e drejta.<sup>18</sup> Mbrojtja dorëzoi më tej parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të Fazliut dhe kërkoi lirimin e përkohshëm të tij deri në fillim të

---

<sup>13</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 24-25, 33, 39, 41-42, 53.

<sup>14</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 47.

<sup>15</sup> F00544, Vendim mbi Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Gjykatësit të Vetëm, 12 nëntor 2025, para. 28.

<sup>16</sup> F00571, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Fazliut për Zgjatje të Afatit për Parashtrime në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 24 nëntor 2025, para. 15-16, 19, ku Gjykatësi i Vetëm (i) autorizoi ZPS-në të dorëzonte parashtrime plotësuese jo më vonë se tri ditë pas vendimit të Panelit mbi Apelin; (ii) autorizoi Fazliun të përgjigjej jo më vonë se pesë ditë pas kalimit të afatit për parashtrime plotësuese nga ZPS-ja; dhe (iii) vendosi të lëshonte vendimin mbi rishikimin e paraburgimit të Fazliut brenda shtatë ditëve pas kalimit të afatit për përgjigje nga Fazliu. Shih gjithashtu, F00562, Kërkesë e Fazliut për Zgjatje të Afatit për t'u Përgjigjur ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Gjashtë të Paraburgimit, 21 nëntor 2025, para. 1, 10, 16.

<sup>17</sup> F00584, Dorëzim i Njoftimit të Fazliut për Heqje Dorë, 28 nëntor 2025.

<sup>18</sup> F00593, Njoftim i Fazliut për Tërheqje të Njoftimit për Heqje Dorë, 2 dhjetor 2025 ("Njoftimi për Tërheqje të Njoftimit për Heqje Dorë").

gjkimit.<sup>19</sup> Më 3 dhjetor 2025, Gjykatësi i Vetëm lëshoi vendimin ku urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Fazliut.<sup>20</sup>

7. Në Apel, Fazliu shtjellon katër pika që kanë të bëjnë me pretendime për gabime ligjore dhe faktike të bëra nga Trupit Gjykues.<sup>21</sup> Fazliu kërkon që Paneli i Gjykatës së Apelit të prapësojë Vendimin e Kundërshtuar dhe të urdhërojë lirimin e menjëhershëm të tij.<sup>22</sup>

## II. STANDARDI I RISHIKIMIT

8. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e shqyrtimit për apelet e ndërmjetme të përcaktuar në vendimin e tij të parë dhe të zbatuar në vijimësi.<sup>23</sup>

## III. PARASHTRIMET PUBLIKE

9. Paneli i Apelit vëren se Vendimi i Kundërshtuar u dorëzua me klasifikimin publik. Megjithëse Fazliu e dorëzoi Apelin si konfidencial, ai kërkon tani që Apeli të riklasifikohet si publik.<sup>24</sup> Përgjigjja dhe Kundërpërgjigjja ndaj Apelit u dorëzuan si konfidenciale në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, por Palët vunë në dukje se këto parashtrime të protokolluara mund të riklasifikoheshin si publike, pasi nuk përmbanin informacion konfidencial.<sup>25</sup> Paneli rikujton se të gjitha parashtrimet e protokolluara para Dhomave të Specializuara duhet të jenë publike, përveç kur ka arsye të posaçme për t'i mbajtur konfidenciale, dhe se palët duhet të dorëzojnë për

---

<sup>19</sup> Njoftim për Tërheqje të Njoftimit për Heqje Dorë, para. 4-10, 11(c).

<sup>20</sup> F00598, Vendim i Gjashtë për Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut, 3 dhjetor 2025 para. 41.

<sup>21</sup> Apeli, para. 18-44, 46. Shih gjithashtu Apelin, para. 1, 2.

<sup>22</sup> Apeli, para. 47.

<sup>23</sup> KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020 ("Vendimi mbi Apelin e Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen në Paraburgim"), para. 4-14. Shih gjithashtu IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 28 janar 2025 ("Vendimi i Apelit të Parë të Kilajt mbi Paraburgimin"), para. 15-17.

<sup>24</sup> Shih IA008/F00004, Kërkesë e Mbrojtjes së Fazliut për Riklasifikim të IA008-F0001, 29 tetor 2025 (konfidenciale) ("Kërkesa për Riklasifikim"), para. 1. Fazliu kërkon gjithashtu që Kërkesa për Riklasifikim të riklasifikohet si publike. Shih Kërkesën për Riklasifikim, para. 2.

<sup>25</sup> Përgjigjja, para. 22; Kundërpërgjigjja, para. 5.

protokollim versione të redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve që i paraqesin Panelit.<sup>26</sup> Rrjedhimisht, Paneli miraton Kërkesën për Riklasifikim dhe urdhëron që Apeli,<sup>27</sup> Përgjigja, Kundërpërgjigja dhe Kërkesa për Riklasifikim të riklasifikohen si publike në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.

#### IV. DISKUTIM

##### A. PRETENDIME PËR GABIME NË LIDHJE ME DETYRIMIN PËR TË DHËNË MENDIM TË ARSYETUAR (PIKA 1)

###### 1. Parashtrimet e Palëve

10. Fazliu parashtron se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk arriti të trajtojë parashtrimet e Mbrojtjes dhe bëri gabim ligjor që nuk dha mendim të arsyetuar në Vendimin e Kundërshtuar.<sup>28</sup> Më konkretisht, Fazliu pretendon se Vendimi i Kundërshtuar thjesht përsërit konstatimet e mëparshme<sup>29</sup> dhe nuk specifikon argumentet e Mbrojtjes që diskutohen aty, as nuk trajton faktet e reja që paraqiti ai.<sup>30</sup> Ai parashtron konkretisht se në Vendimin e Kundërshtuar nuk përmendet roli i tij jo si luftëtar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), as profesioni që e ka ushtruar gjatë gjithë jetës në sektorin privat, as mospasja e kontaktit me Thaçin, përveç gjatë vizitës më 2 korrik.<sup>31</sup>

11. Fazliu argumenton më tej se është e pamundur të kuptohet se si Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të arrinte në konstatimin se ai ka mjete për të penguar

---

<sup>26</sup> Shih p.sh., KSC-BC-2020-06, IA008/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) ("Vendimi i Dytë i Apelit të Veselit"), para. 8-9. Shih gjithashtu KSC-CA-2022-01, F00103, Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikim ose Versione të Redaktuara Publike të Vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 janar 2023, para. 2.

<sup>27</sup> Riklasifikimi nuk ka të bëjë me Shtojcën e Apelit, e cila duhet të mbetet konfidenciale.

<sup>28</sup> Apeli, para. 18, 27, 30. Shih gjithashtu Apelin, para. 19, 28-29, 46.

<sup>29</sup> Apeli, para. 27. Fazliu thekson gjithashtu se në Vendimin e Kundërshtuar i referohet gabimisht Vendimit të Tretë të Rishikimit në vend të Vendimit të Katërt të Rishikimit, Shih Apelin, poshtëshënimi, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 50.

<sup>30</sup> Apeli, para. 20-22.

<sup>31</sup> Apeli, para. 20.

procesin, ndërsa ai nuk njihet ose "nuk ka dijeni" për disa persona me interes për proces gjyqësor para Dhomave të Specializuara.<sup>32</sup> Sipas mendimit të tij, Vendimi i Kundërshtuar shpërfill jurisprudencën e Dhomës së Gjykatës së Apelit në bazë të cilës atmosfera e përgjithshme e frikësimit në Kosovë nuk mund të përbëjë, në vetvete, rrezik për pengim në lidhje me një person konkret.<sup>33</sup>

12. Duke theksuar se ai nuk mban rol politik dhe se rrjeti që e mbështet "përbëhet vetëm nga familja e tij", Fazliu parashtron se në Vendimin e Kundërshtuar nuk përmendet asnjë provë që e lidh atë me atmosferën e frikësimit.<sup>34</sup> Ai argumentin gjithashtu se është e pamundur të kuptohet se si Gjykatësja e Procedurës Paraprake arriti në përfundimin e saj duke pasur parasysh konstatimin e Dhomës së Gjykatës së Apelit lidhur me mungesën e ndikimit për të penguar procesin e z. Rexhep Selimi ("Selimi") dhe z. Jakup Krasniqi ("Krasniqi").<sup>35</sup> Sipas Fazliut, në Vendimin e Kundërshtuar nuk ka arsyetim se si ai mund të ketë "mjete më të mira praktike" për të ikur, se sa një "person me ndikim më të madh që mban pasaportë shqiptare" sikurse Kuçi, veçanërisht duke pasur parasysh se dokumentet e udhëtimit i janë konfiskuar atij.<sup>36</sup>

13. Fazliu parashtron në fund se në Vendimin e Kundërshtuar përsëriten thjesht konstatimet e mëparshme dhe jo "vetëm që është i shkurt" por edhe "krijon një listë të pashterueshme të paqartësive" "asnjë arsyetim të artikulueshëm", deri në një shkallë të tillë sa asnjë lexues i arsyeshëm nuk mund të kuptojë se ai u arrit përfundimi.<sup>37</sup>

14. ZPS-ja përgjigjet se Fazliu thjesht nuk pajtohet me Vendimin e kundërshtuar dhe/ose e keqinterpreton atë.<sup>38</sup> ZPS-ja argumenton veçanërisht se: (i) në Vendimin e

---

<sup>32</sup> Apeli, para. 23.

<sup>33</sup> Apeli, para. 24.

<sup>34</sup> Apeli, para. 25.

<sup>35</sup> Apeli, para. 25.

<sup>36</sup> Apeli, para. 26.

<sup>37</sup> Apelit, para. 27- 29. Shih gjithashtu Apelin, para. 30.

<sup>38</sup> Përgjigja, para. 6. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 2, 7-9.

Kundërshtuar "përsëriten në mënyrë shteruese" parashtrimet e Fazliut dhe "shqyrtohen qartë" argumentet e tij dhe informacionin që dha ai;<sup>39</sup> (ii) fakti nëse Fazliu i njeh personalisht personat konkret nuk ka ndikim në konstatimin se ai ka mjete për të penguar;<sup>40</sup> (iii) atmosfera e përgjithshme e frikësimit u vlerësua si duhet në Vendimin e Kundërshtuar;<sup>41</sup> dhe (iv) kur vlerësohen rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit nuk ka nevojë të jepet një analizë gjithëpërfshirëse lidhur me persona të tjerë.<sup>42</sup>

15. Sipas ZPS-së, në Vendimin e Kundërshtuar rrethanat e Fazliut janë shqyrtuar "plotësisht dhe tërësisht", pasqyron vlerësim "të arsyetuar me kujdes dhe rrënjësisht", dhe zbaton saktë kornizën ligjore.<sup>43</sup>

## 2. Vlerësimi Panelit të Gjykatës së Apelit

16. Paneli i Apelit i kthehet si pari pretendimit të Fazliut se parashtrimet e Mbrojtjes nuk janë trajtuar në Vendimin e Kundërshtuar.<sup>44</sup> Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton se, megjithëse një panel duhet të japë arsytet që mbështesin konstatimet e veta mbi aspektet materiale relevante për vendimin, nuk është e nevojshme që ai të sqarojë çdo hap të arsytimit të vet e as të trajtojë të gjitha argumentet e paraqitura nga palët, ose çdo provë që ka lidhje me një konstatim konkret, në qoftë se ka paraqitur bazën e vendimit të vet me qartësi të mjaftueshme.<sup>45</sup>

---

<sup>39</sup> Përgjigja, para. 7.

<sup>40</sup> Përgjigja, para. 8.

<sup>41</sup> Përgjigja, para. 9.

<sup>42</sup> Përgjigja, para. 10.

<sup>43</sup> Përgjigja, para. 6, 11.

<sup>44</sup> Shih Apelin, para. 22, 30.

<sup>45</sup> Shih KSC-CA-2023-02, F00038/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 dhjetor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 14 dhjetor 2023) ("Aktgjykimi i Apelit"), para. 34; KSC-CA-2024-03, F00069/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 korrik 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 14 korrik 2025) ("Aktgjykimi i Apelit"), para. 43. Shih gjithashtu, KSC-CA-2022-01, F00114, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023 (konfidencial), para. 33; KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit t kundër Vendimit lidhur me Lirimimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021) ("Vendimi i Parë i Apelit të Selimit"), para. 45 me referencat që citohet aty.

17. Në rastin aktual, Paneli vë në dukje se në Vendimin e Kundërshtuar arsyetimi në lidhje me rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit është relativisht i shkurt dhe se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk shtjellon në shumë hollësi se si arriti në përfundimin faktik. Në vend të asaj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake iu referua përgjithësisht në poshtëshënime konstatimeve nga vendimet e mëparshme të saj mbi rishikimin e paraburgimit të Fazliut. Sidoqoftë, Paneli vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake iu referua shprehimisht parashtrimeve të Mbrojtjes që Fazliu pretendon se i shpërfilli ajo,<sup>46</sup> përmbledhja e të cilave u dha në hollësi në pjesë të tjera në Vendimin e Kundërshtuar.<sup>47</sup> Sipas mendimit të Panelit, dhe në kundërshtim me parashtrimin e Fazliut, pjesët përkatëse në Vendimin e Kundërshtuar, lexuar së bashku, mundësojnë identifikimin e argumenteve konkrete të Mbrojtjes që i diskutoi Gjykatësja e Procedurës Paraprake në paragrafët 29 dhe 35 të Vendimit të Kundërshtuar.<sup>48</sup> Po ashtu, sipas mendimit të Panelit, detyrimi për të dhënë një mendim të arsyetuar nuk do të thotë se përfshin detyrimin e një gjykate të shkallës më të ulët që t'u referohet "hollësive në imtësi" që përbëjnë bazën e argumenteve të Mbrojtjes,<sup>49</sup> as "forcën dhe arsyeshmërinë e parashikimeve të Mbrojtjes lidhur me hollësitë faktike".<sup>50</sup> Rrjedhimisht, pretendimet e Fazliut në lidhje me këtë hedhen poshtë menjëherë.

18. Sa i përket faktit se Gjykatësja e Procedurës Paraprake "thjesht përsëriti" konstatimet e mëparshme,<sup>51</sup> Paneli i Apelit rikujton se kur kryhet vlerësimi i rrezikut

---

<sup>46</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 29, 35.

<sup>47</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 9-10, që u referohet, ndër të tjera Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 8-15, 19-21, 23, 29-30, 32-35.

<sup>48</sup> Shih Apelin, para. 20. Krahas kësaj, Paneli vë në dukje se Gjykatësja e Procedurës Paraprake u referohet drejtpërdrejtë parashtrimeve të Mbrojtjes në vlerësimin e saj të rrezikut të pengimit. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 35, poshtëshënime 63-64, 66-67, që u referohen parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 11-15, 23-25, 28-30, 32-33.

<sup>49</sup> Shih Apelin, para. 20.

<sup>50</sup> Shih Apelin, para. 21.

<sup>51</sup> Shih Apelin, para. 27. Sa i takon faktit që Gjykatësja e Procedurës Paraprake iu referua Vendimit të Tretë të Rishikimit për shqyrtimin e saj të proporcionalitetit të paraburgimit të Fazliut, Paneli konstaton se ky referim ishte gabim shtypi dhe konstaton se është e qartë nga pjesa tjetër e Vendimit të

sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, asgjë nuk e pengon një panel të shkallës më të ulët të mbështetet në një faktor mbi të cilin është mbështetur më parë, pavarësisht se kur janë paraqitur për herë të parë provat që mbështesin këtë faktor, për sa kohë që bindet se, në kohën e marrjes së vendimit, provat vijojnë të jenë të mjaftueshme për të përligjur konstatimin në fjalë.<sup>52</sup> Me rëndësi është që faktorët që u shqyrtuan më parë nga paneli i shkallës së ulët të vijojnë të jenë të mjaftueshme për të treguar se vazhdon të ekzistojë ky rrezik, dhe se nuk ka pasur faktor të ri që do të përligjte rishikimin e faktorëve të mëparshëm.<sup>53</sup> Paneli thekson se Fazliu nuk arrin të paraqesë faktorë të ri që përligjin rishikimin e faktorëve të konstatuar më parë, as të tregojë se nuk përligjet më mbështetja e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në këta faktorë.

19. Sa i takon pretendimit të Fazliut se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk arriti të trajtonte "fakte të reja" që ai ia paraqiti asaj,<sup>54</sup> Paneli vë në dukje se Fazliu nuk evidenton në apel asnjë fakt ose informacion të ri që paraqiti ai, dhe që pretendohet se e shpërfilli Gjykatësja e Procedurës Paraprake. Sido që të jetë, Paneli vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh shprehimisht faktin se Fazliu paraqiti informacion "shtesë".<sup>55</sup>

---

Kundërshtuar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerësoi kohën shtesë që Fazliu ka kaluar në paraburgim që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit. *Krahaso* Vendimin e Kundërshtuar, para. 50 me Vendimin e Kundërshtuar, para. 48-49.

<sup>52</sup> Shih. p.sh. KSC-BC-2020-06, IA035/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit, 14 gusht 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 13 gusht shkurt 2025), para. 18, ("Vendimi i Pestë i Apelit për Paraburgimin e *Krasniqit*"), para 28. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-04, IA003/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 11 shkurt 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 shkurt 2022), para. 18.

<sup>53</sup> Shih p.sh. Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Krasniqit*, para. 28; KSC-BC-2020-06, IA006/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e *Krasniqit*"), para. 14-16.

<sup>54</sup> Shih Apelin, para. 19, 22. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së ZPS-së, para. 6.

<sup>55</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 17, që i referohet "informacion të ri të paraqitur" nga Mbrojtja.

20. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli është bindur se Gjykatësja e Procedurës Paraprake trajtoi plotësisht argumentet e Mbrojtjes dhe dha arsye të mjaftueshme se si arriti në konstatimet e saj. Rrjedhimisht, pretendimet e Fazliut në lidhje me këtë hedhen poshtë menjëherë.

21. Paneli do të trajtojë tani argumentet e Fazliut në lidhje me konstatimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake se ai ka mundësinë të kontaktojë bashkëpunëtorë dhe të fitojë mbështetje nga persona besnikë ndaj tij për të ikur dhe/ose penguar procesin.<sup>56</sup> Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se pyetja që ngre neni 41(6)(b) i Ligjit është se a paraqiti ZPS-ja *arsyetim konkret të bazuar në prova* që mbështesin bindjen për një mundësi mjaftueshëm reale që të ekzistojë (një apo më shumë) prej rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.<sup>57</sup> Vlerësimi nëse provat e paraqitura nga ZPS-ja janë të mjaftueshme, është çështje faktesh që varet nga rrethanat individuale të secilit rast.<sup>58</sup> Paneli rikujton më tej se vlerësimi i provave bëhet, në radhë të parë, nga gjykatësi që shqyrton kërkesën për lirim të përkohshëm. Prandaj, gjatë përcaktimit nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerësoi gabimisht faktet në një vendim për lirim të përkohshëm, Paneli i Apelit ndërhyr vetëm në rast të një gabimi të qartë, përkatësisht kur nuk e ka të qartë se si Gjykatësja e Procedurës Paraprake arriti logjikisht në atë përfundim bazuar në provat përpara saj.<sup>59</sup>

22. Paneli thekson se, për të mbështetur përfundimin se Fazliu mund të marrë mbështetjen e veteranëve të UÇK-së me ndikim dhe/ose personave të tjerë besnikë ndaj tij, Gjykatësja e Procedurës Paraprake u referohet thjesht konstatimeve që i bëri

---

<sup>56</sup>Shih Apelin, para. 22, 25. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para 29, 35.

<sup>57</sup> Shih p.sh. KSC-BC-2020-06, IA033/F00006, Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit, 13 gusht 2025 ("Vendimi i Pestë i Apelit të *Selimit* mbi Paraburgimin"), para. 28 (theksimi në origjinal); KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2001, ("Vendimi i Parë i Apelit të *Veselit* mbi Paraburgimin"), para. 11ilajt 9; IA004/F00005, Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit, 1 shtator 2025, para. 67.

<sup>58</sup> Vendimi i Pestë i Apelit të *Selimit* mbi Paraburgimin, para. 28; Vendimi i Parë i Apelit të *Selimit* mbi Paraburgimin, para. 44.

<sup>59</sup> Shih p.sh. Vendimin e Parë të Apelit të *Selimit* mbi Paraburgimin, para. 64.

në vendimet e mëparshme.<sup>60</sup> Pasi ka shqyrtuar provat mbështetëse bazë të paraqitura nga ZPS-ja dhe të vlerësuara në këto vendime nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Paneli i Apelit kupton lehtë se si Gjykatësja e Procedurës Paraprake arriti në përfundimin faktik, veçanërisht duke pasur parasysh se ajo i referohet Vendimit për Arrestimin, që nga ana e tij u referohet parashtrimeve dhe dokumentacionit mbështetës nga ZPS-ja.<sup>61</sup>

23. Paneli vë në dukje më tej se, megjithëse duket se Fazliu ngre kundërshtime lidhur me konstatimet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në lidhje me profilin dhe lidhjet e tij me komunitetin e tij në apel dhe në parashtrimet e fundit para saj, ai i theksoi këto aspekte në parashtrimet të mëparshme.<sup>62</sup> Gjithashtu, ndonëse është e

<sup>60</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 26, 29, 35, poshtëshënimet 53, 56-57.

<sup>61</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 29, poshtëshënimi 56, që i referohet, ndër të tjera, Vendimit për Arrestimin, para. 83, që, nga ana e tij i referohet F00023/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Prokurorisë sipas F00022 me Shtojcat 1-5 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 13 dhjetor 2024 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 17 tetor 2024, versioni i redaktuar rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 27 nëntor 2024, riklasifikuar si konfidencial më 6 dhjetor 2024) ("Parashtrimet të ZPS-së për Arrestimin"), para. 6-8 dhe F00023/A02, Shtojca 2 e Parashtrimeve të Prokurorisë sipas F00022, 18 tetor 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*). Versioni i redaktuar konfidencial i Shtojcës 2 u dorëzua më vonë. Shih F00069/A01, Version i Redaktuar Konfidencial i Shtojcës 2 të Parashtrimit të Prokurorisë sipas F00022, 9 dhjetor 2024 (konfidencial) ("Shtojca e Parashtrimeve të ZPS-së për Arrestimin").

<sup>62</sup> *Krahaso* Apelin, para. 25 ("Z. Fazliu nuk ka pozitë politike; rrjeti mbështetës përbëhet vetëm prej familjes së tij") dhe Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 11 ("Z. Fazliu nuk ka 'karrierë të gjatë politike. Ai është shumë larg nga të qenit politikan. Ai nuk ka mbajtur kurrë post publik as nuk ka ndjekur karrierë politike"), 12 ("Ngatërresa midis profilit politik të z. Fazliu mund të ketë lindur nga fakti që familja e Fazliut në fakt është e respektuar në Kosovë. Megjithatë, respekti ka lindur nga sakrifica që kjo familje dha për pavarësinë e Kosovës"). 13 ("Z. Fazliu ka pasur një jetë të thjeshtë dhe modeste, kryesisht larg publikut. Para arrestimit, atë pak vëmendje që mori z. Fazliu, e mori vetëm në lidhje me përkujtimet për vëllezërit e tij. Edhe pasi ky proces gjyqësor mori vëmendjen e mediave, lajmet vazhdojnë ta identifikojnë nëpërmjet lidhjes së tij me heronj, e jo atë vetë si figurë me ndikim."), 14 ("Lidhjet e z. Fazliu me ish-anëtarë të UÇK-së janë gjithashtu vetëm në këtë kontekst."), *me* F00245/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut mbi Rishikimin e Paraburgimit, 4 prill 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 2 prill 2025) ("Parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me Rishikimin e Dytë zë Paraburgimit"), para. 8 ("Ai është aktivist i mirënjohur për çështjen kombëtare, dhe person që ka reputacion të shkëlqyer në komunitetin ku jetoi dhe punoi ai. Familja Fazliu është familje e respektua dhe ka marrë në fakt dekoratë me nderime të larta shtetërore për përpjekjet e tyre për lirinë e populli. Është nderuar nga Presidenca e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Kosovës."), 9 ("Familja Fazliu njihet anëmbanë Kosovës. [...] Z. Fazliu vetë dha kontribut për lirinë e vendit dhe të tjerët kanë respekt dhe konsideratë ndaj tij. [...] Autoriteti i tij, të cilin e fitoi nëpërmjet përpjekjes së konsiderueshme tij, ka qenë burim i ndihmesës për ata që i drejtoheshin për

saktë se Fazliu nuk ka pozitë politike aktualisht,<sup>63</sup> ai e përshkruan vetën si "aktivist i mirënjohur"<sup>64</sup> dhe më tej shpërfill provat që konfirmojnë karrierën politike të tij.<sup>65</sup> Po kështu, në lidhje me pretendimin e Fazliut në apel se "rrjeti mbështetës i tij përbëhet vetëm prej familjes së tij"<sup>66</sup> Paneli i Apelit rikujton parashtrimet e mëparshme të Fazliut ku ai e përshkruan vetën si person me "autoritet", "të njohur në mbarë Kosovën", "ndaj të cilit të tjerët kanë respekt dhe konsideratë" dhe i cili e përkrahu fshatin e tij "në çdo aspekt".<sup>67</sup> Sa u takon lidhjeve të tij me udhëheqës të UÇK-së me ndikim, sikurse z. Thaçi, Fazliu thotë vet se lidhja e tij me Thaçin është "me dekada e gjatë" dhe "sentimentale dhe komemorative".<sup>68</sup>

---

ndihmë. Ai ka mbështetur fshatin ku ai u lind dhe familjen e tij në çdo aspekt, kur kishte mundësi, si moralisht ashtu edhe financiarisht.") dhe F00278/RED, Versionin e Redaktuar Publik të Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut mbi Rishikimin e Tretë të Paraburgimit, 8 maj 2025 (versioni i redaktuar u dorëzua më 4 maj 2025), para. 16 ("Z. Fazliu ka treguar lidhje të palëkundshme me Kosovën; banor i përhershëm që mbi 47 vjet, bashkëshort dhe baba i përkushtuar, me reputacion të fortë në mesin e komunitetit të tij.").

<sup>63</sup> Shih Apelin, para. 25.

<sup>64</sup> Shih Parashtrimet e Mbrojtjes mbi Rishikimin e Dytë të Paraburgimit, para. 8. Krahas kësaj, disa prej artikujve që i paraqiti Fazliu në parashtrimet para Gjykatësës së Procedurës Paraprake në fakt e paraqesin Fazliun si "aktivist kombëtar" dhe si person që e nderoi Ramush Haradinaj në 2021 "për kontributin e jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare" dhe si person që "ishte tërë kohën përkrah aktivitetit kombëtar, bashkë me vëllezërit e tij, duke vazhduar edhe pas çlirimit kontributin në ndërtimin e vendit." Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, poshtëshënimi 18, që i referohet, ndër të tjera "Haradinaj nderon vëllain e dy heronjve, Fadil Fazliun" (20 prill 2021) *Indeksonline* <<https://indeksonline.net/en/haradinaj-nderon-vellain-e-dy-heronjve-fadil-fazliun/>> (e marrë më 2 dhjetor 2025).

<sup>65</sup> Shih, p.sh., Parashtrimet e ZPS-së mbi Arrestimin para. 7, që u referohen Shtojcës së Parashtrimeve të ZPS-së mbi Arrestimin, f. 68, 83, (SPOE00360385) (ku Fazliu renditet si kandidat për partitë e koalicionit PDK, AAK dhe Nisma për zgjedhjet parlamentare të Kosovës të vitit 2017). Shih gjithashtu Vendimin mbi Arrestimin, para. 83. Krahas kësaj, Fazliu nuk pati sukses si kandidat i Lëvizjes për Bashkim në zgjedhjet parlamentare të Kosovës në vitin 2014. Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, poshtëshënimi 11.

<sup>66</sup> Shih Apelin, para. 25.

<sup>67</sup> Shih Parashtrimet e Mbrojtjes mbi Rishikimin e Dytë të Paraburgimit, para. 9. Shih gjithashtu Vendimin e Dytë të Rishikimit, para. 34, ku Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se parashtrimet e Fazliut në lidhje me familjen dhe komunitetin e tij në fakt përforcojnë konstatimin se ai përfiton nga një rrjet i gjerë mbështetës në Kosovë.

<sup>68</sup> Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 23. Paneli vë në dukje më tej se në kërkesë për të vizituar Thaçin në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, Fazliu thotë se i "mungon [Thaçi]", se ka "30 vite që e njeh" dhe se ata kanë "lidhje të forta shoqërore dhe familjare". Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, poshtëshënimi. 47, që i referohet 121877-121884-ET. Shih gjithashtu Përgjigjen e Prokurorisë në lidhje me Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 7.

24. Rrjedhimisht, dhe duke pasur parasysh provat e ZPS-së, Paneli nuk gjykon se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që konfirmoi se nuk ndryshojnë konstatimet në lidhje me karrierën politike të Fazliut dhe mundësinë e tij për të ikur dhe penguar procesin.<sup>69</sup> Paneli as nuk arrin të kuptojë se si fakti që Fazliu ka punuar në sektor privat, nuk ka pasur rol ushtarak në UÇK dhe se pretendohet se ndërpreu të gjitha lidhjet me Thaçin që nga vizita më 2 korrik 2023 mund të ndikojë në konstatimet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake.<sup>70</sup> Rrjedhimisht, argumentet e Fazliut hedhen poshtë.

25. Paneli i kthehet tani referimit të Fazliut në faktin që për Selimin dhe Krasniqin u gjykua se nuk ishin ndikim për të penguar, përkundër pozitive të larta të tyre në UÇK.<sup>71</sup> Paneli thekson së pari se Fazliu e paraqet këtë argument për herë të parë në apel, çka përlligj hedhjen poshtë të menjëhershme.<sup>72</sup> Së dyti, Paneli konstaton se krahasimet me konstatime që kanë të bëjnë me të akuzuar në çështje gjyqësore të tjera para Dhomave të Specializuara nuk ka rëndësi për vlerësimin e rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, meqë vlerësimi i rrezikut varet pashmangshmërisht nga rasti konkret dhe bazohet në rrethanat individuale të secilit prej të akuzuarve. Sido që të jetë, Paneli vë në dukje se asnjë nga konstatimet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në lidhje me "rrjetin mbështetës" të Fazliut nuk kanë të bëjnë me Selimin ose Krasniqin.<sup>73</sup> Krahas kësaj, konstatimet e Gjykatësës së

---

<sup>69</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 29, 35.

<sup>70</sup> Shih Apelin, para. 20.

<sup>71</sup> Shih Apelin, para. 25, që i referohet Vendimit të Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 16-17; KSC-BC-2020-06, IA002/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Krasniqit*"), para. 52.

<sup>72</sup> Shih, p.sh., KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021 ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*"), para. 29. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Mustafa*, para. 30. Shih Aktgjykimin e Apelit *Shala*, para. 39.

<sup>73</sup> Shih konkretisht Vendimin mbi Arrestimin, para. 83 dhe personat që përmenden aty.

Procedurës Paraprake në lidhje me Fazliun në këtë çështje gjyqësore dallojnë nga konstatimet e Dhomës së Gjykatës së Apelit në lidhje me Selimin dhe Krasniqin.<sup>74</sup>

26. Megjithëse Fazliu kundërshton që Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë pretendimin e tij se ai nuk njih ose nuk ka dijeni për disa persona me interes për proces gjyqësor para Dhomave të Specializuara,<sup>75</sup> Apeli vëren se Fazliu thjesht përsërit argumentet që i ka trajtuar Gjykatësja e Procedurës Paraprake, pa evidentuar asnjë gabim në vlerësimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake që do të përlligjte ndërhyrjen e Panelit të Apelit.<sup>76</sup> Rrjedhimisht, ky argument hidhet poshtë menjëherë.<sup>77</sup> Sido që të jetë, Paneli nuk sheh gabim në konstatimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake se mungesa e dijenisë e pretenduar për persona me interes për procesin gjyqësor nuk ndryshon konstatimin se ai ka mjete për të penguar procesin.<sup>78</sup> Në fakt, Apeli konstaton se aspekti nëse një i akuzuar nuk njih personalisht persona me interes dhe/ose dëshmitarë të mbrojtur në procese para Dhomave të Specializuara nuk është relevant për përcaktimin nëse ekziston rreziku që ky i akuzuar të pengojë procesin. Kjo vlen edhe më shumë kur i akuzuari ka qasje në identitetet e këtyre personave, sikurse është rasti në fjalë.<sup>79</sup>

---

<sup>74</sup> Në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-06, Dhoma e Gjykatës së Apelit ku pranoi pozitat me ndikim të Selimit dhe Krasniqit, megjithatë konstatoi se nuk kanë mundësinë për të mobilizuar një rrjet mbështetës, meqë nuk ishin paraqitur prova në lidhje me përbërje të rrjetit mbështetës, kapacitet ose burime të tij. Shih Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 66; Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Krasniqit*, para. 55. Në dallim nga çështja aktuale, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka bërë konstatim në lidhje me ndikimin e pretenduar të *vetë* Fazliut, por vetëm konstatoi se ai mund të kërkojë mbështetje nga ish-komandantë të UÇK-së "me ndikim të rrënjosur politikë" për shkak të "lidhjeve të ngushta" me këta persona. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 29; Vendimin mbi Arrestimin, para. 83.

<sup>75</sup> Shih Apelin, para. 23.

<sup>76</sup> *Krahaso* Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 29 *me* Apelin, para. 23.

<sup>77</sup> Shih p.sh. Aktgjykimin e Apelit *Shala*, para. 42; Aktgjykimin e Apelit *Mustafa*, para. 33; Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 29.

<sup>78</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 35.

<sup>79</sup> Shih F00172/RED, Versionin e Redaktuar Publik të Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse, 11 mars 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 shkurt 2025); F00295/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Masa Mbrojtëse dhe Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë, 5 shtator 2025 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua

27. Duke iu kthyer pretendimit të Fazliut se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk dha shpjegim përse Fazliu ka "mjete praktike për të ikur më të mira" se Kuçi,<sup>80</sup> Paneli konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka detyrim për të bërë krahasimin që sugjeron Fazliu. Paneli rikujton se konstatimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake në lidhje me rrezikun që mund të paraqesë një i bashkakuar tjetër nuk është relevant, meqenëse vlerësimi i rrezikut bazohet në një vlerësim të individualizuar të rrethanave personale për secilin prej të akuzuarve.<sup>81</sup> Sido që të jetë, Paneli vë në dukje se pretendimi i Fazliut se Kuçi ka "lidhje me të ngushta" ose që ka "ndikim politik më të madh" është i pabazë.<sup>82</sup> Paneli vë në dukje më tej se konstatimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake se Kuçi nuk paraqet rrezik të arratisjes nuk u mbështet në ndikimin (politik) ose rrjetin e tij, por në peshën relative të veprës penale dhe dënimit relativisht të vogël me të cilin mund të përballet - konkretisht deri në gjashtë muaj burgim.<sup>83</sup>

28. Paneli tani i kthehet kundërshtimit të Fazliut që Gjykatësja e Procedurës Paraprake i referohet atmosferës së përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë. Paneli i Apelit rikujton se, megjithëse ky është faktor kontekstual relevant që duhet të merret parasysh për vlerësimin nëse ekzistojnë rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit, ky faktor, i vetëm, është i pamjaftueshëm për të përligjur vazhdimin e paraburgimit.<sup>84</sup>

29. Megjithatë, Paneli vë në dukje se Gjykatësja e Procedurës Paraprake e mori parasysh këtë faktor vetëm si faktor kontekstual bazë.<sup>85</sup> Një lexim i thjesht i Vendimit

---

më 12 maj 2025, versioni konfidencial i redaktuar u dorëzua më 12 maj 2025). Shih gjithashtu F00428/A01, Shtojcën 1 të Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut në lidhje me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit, 29 gusht 2025 (konfidencial) ("Shtojca 1 e Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake"), poshtëshënimi 1.

<sup>80</sup> Shih Apelin, para. 26.

<sup>81</sup> Shih më lart, para. 25

<sup>82</sup> Shih Apelin, para. 26; Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 17.

<sup>83</sup> Shih Vendimin mbi Arrestimin, para. 93-94.

<sup>84</sup> Shih Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit* para. 31; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Kilajt*, para. 82.

<sup>85</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 38.

të Kundërshtuar tregon se Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerësoi rrezikun e ecurisë së procesit të Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit bazuar në faktorë të tjerë<sup>86</sup> dhe theksoi qartë se ajo vlerësoi këta faktorë "në kontekst" të atmosferës së frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve (të mundshëm) që japin dëshmi para Dhomave të Specializuara.<sup>87</sup> Rrjedhimisht, në kundërshtim me pretendimin e Fazliut, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk "shpërfilli" jurisprudencën e Dhomës së Gjykatës së Apelit dhe nuk u mbështet vetëm në këtë faktor për të konstatuar se rreziku që Fazliu të pengojë procesin vazhdon të jetë veçanërisht i lartë.<sup>88</sup> Rrjedhimisht, argumenti i Fazliut hidhet poshtë.

30. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Fazliu nuk ka arritur të vërtetojë se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk dha arsye dhe gaboi që konstatoi se nuk ka arsye të artikulueshme për të besuar se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet që, në qoftë se lirohet, Fazliu të pengojë ecurinë e procesit të Dhomave të Specializuara dhe/ose të kryejë vepra penale të tjera, të parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.<sup>89</sup> Rrjedhimisht, Paneli e rrëzon pikën e parë të apelit të Fazliut.

---

<sup>86</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 34-37. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh faktorët në vijim: (i) lloji i akuzave të konfirmuara kundër z. Fazliu i cili ka qenë pjesëtar i një grupi të drejtuar nga z. Thaçi, që synonte të ndikonte paligjshëm ndaj dëshmitarëve; (ii) dijenia që ka demonstruar e z. Fazliu lidhur me synimet penguese të z. Thaçi si dhe synimi i tij për t'i realizuar ato; (iii) këmbëngulja dhe gatishmëria e tij për të penguar procesin e Dhomave të Specializuara duke ndihmuar për realizimin e interesave dhe urdhrave të udhëheqjes së lartë të UÇK-së; (iv) aftësia e tij për të marrë pëlqimin e personave që janë besnik ndaj tij, përfshirë të djalit të tij, me qëllim pengimin e procesit penal të DHS-së; dhe (v) dijenia e tij në rritje lidhur me provat inkriminuese kundër tij. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 34

<sup>87</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 38.

<sup>88</sup> Shih Apelin, para. 24.

<sup>89</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 33, 39, 41-42.

B. GABIMET E PRETENDUARA NË LIDHJE ME VLERËSIMIN PREJ GJYKATËSES SË  
PROCEDURËS PARAPRAKE TË GARANCIVE TË FAZLIUT (PIKA 2)

**1. Parashtrimet e Palëve**

31. Fazliu parashtron se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që hodhi poshtë deklaratën në lidhje me synimet e tij dhe për reputacion si të pamjaftueshme për të ndryshuar vlerësimin objektiv të rrezikut të arratisjes dhe pengimit.<sup>90</sup> Sipas mendimit të tij, interpretimi prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake të faktorëve që janë relevant për kryerjen e një vlerësimi objektiv të rrezikut është i gabuar dhe përbën gabim ligjor.<sup>91</sup>

32. Sa i përket deklaratës për synimet e tij, Fazliu i referohet konkretisht një letre të dorëzuar si shtojcë e Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake.<sup>92</sup> Në komentin lidhur me letrën, Fazliu thekson se ai shprehu gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me Dhomat e Specializuara dhe për t'u përballur me akuzat kundër tij.<sup>93</sup> Fazliu rikujton se ai shprehu gatishmërinë e tij për të përmbushur çdo kusht që do të përcaktojë Gjykatësja e Procedurës Paraprake, në qoftë se miratohet kërkesa e tij për lirim me kusht. Ai shprehu gjithashtu respektin e tij për autoritetin e Dhomave të Specializuara.<sup>94</sup> Krahas kësaj, Fazliu rikujton se ai u zotua se nuk do të shfrytëzonte emrin dhe respektin e fituar në komunitet, për shkak të vëllezërve martirë, për t'i ikur drejtësisë.<sup>95</sup>

---

<sup>90</sup> Apeli, para. 2, 31. Shih gjithashtu Apelin, para. 32-35.

<sup>91</sup> Apeli, para. 35.

<sup>92</sup> Shih Shtojcën 1 të Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake.

<sup>93</sup> Apeli, para. 32.

<sup>94</sup> Apeli, para. 32.

<sup>95</sup> Apeli, para. 32.

33. Fazliu argumenton se përkushtimi i tij si dhe zotimi nga dy anëtarë të familjes së tij<sup>96</sup> që u dorëzuan gjithashtu si shtojca të Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, u hodhën poshtë gabimisht si "jo objektive".<sup>97</sup>

34. Në lidhje me këtë, Fazliu parashtron se jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ") mbështet pretendimin se faktorët që kanë të bëjnë me gjendjen mendore, personalitetin dhe karakterin moral të një të akuzuari vazhdojnë të janë relevante për vlerësimin që kryhet sipas nenit 41(6) të Ligjit.<sup>98</sup> Fazliu parashtron se kujtimet për vëllezërit e tij dhe reputacioni i tyre, si dhe fakti që ai kupton pasojat e shkeljes së zotimit në deklaratën në lidhje me synimet e tij "përshihet qartë në kategorinë" e faktorëve relevant në kuadër të këtij vlerësimi.<sup>99</sup>

35. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Fazliut pasqyrojnë thjesht mospajtimin e tij me Vendimin e Kundërshtuar dhe se, në kundërshtim me pretendimet e tij, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i peshoi si duhet të gjithë faktorët relevantë kur vlerësoi rrezikun që Fazliu mund të ikë ose të pengojë procesin e Dhomave të Specializuara.<sup>100</sup>

36. ZPS-ja parashtron se argumentet e Fazliut janë në dobi të interesave të tij dhe se: (i) deklarimi i Fazliut se respekton autoritetin e Dhomave të Specializuara është në kundërshtim me ekzistencën e dyshimit të bazuar se ai ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe për rrezikun objektiv të arratisjes dhe

---

<sup>96</sup> Apeli, para. 34, që u referohet F00428/A02, Shtojcë 2 e Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut në lidhje me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit, 29 gusht 2025 (konfidenciale) ("Shtojca 2 e Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut para Gjykatësës së Procedurës Paraprake") dhe F00428/A03, Shtojcë 3 e Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut në lidhje me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit, 29 gusht 2025 (konfidenciale) ("Shtojca 3 e Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut para Gjykatësës së Procedurës Paraprake").

<sup>97</sup> Apeli, para. 34. Fazliu shton se rreziku i një dënimi të lartë dhe faktet inkriminuese, edhe pse të identifikueshme lehtë, nuk janë vendimtare në vetvete. Shih Apelin, para. 34, që u referohet ECtHR, *Maksim Savov v. Bulgaria*, no. 28143/10, Judgment, 13 October 2020 ("*Maksim Savov v. Bulgaria* Judgment"), para. 48; ECtHR, *Becciev v. Moldova*, no. 9190/03, Judgment, 4 October 2005 ("*Becciev v. Moldova* Judgment"), para. 58.

<sup>98</sup> Apeli, para. 33, që i referohet *Maksim Savov v. Bulgaria* Judgment, para. 48.

<sup>99</sup> Apeli, para. 33.

<sup>100</sup> Përgjigjja, para. 12. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 13-14.

pengimit që paraqet ai:<sup>101</sup> (ii) kur u referohet zotimeve të anëtarëve të familjes, Fazliu shpërfill me qëllim konstatimin se rreziku i pengimit u bazua konkretisht në mendimin se ai ka mundësinë që të fitojë pajtimin e personave besnikë ndaj tij, përfshirë nga një anëtarë i familjes që dha zotimin;<sup>102</sup> dhe (iii) kujtimet për vëllezërit dhe reputacioni i tyre janë jorelevantë për vlerësimin që kreu Gjykatësja e Procedurës Paraprake.<sup>103</sup>

37. Fazliu kundërpërgjigjet se parashtrimet e ZPS-së "anashkalojnë qartë një skenar ku ai është i pafajshëm faktikisht" dhe shton se ekzistenca e dyshimit të bazuar se ai kreu veprat penale për të cilat akuzohet në Aktakuzë nuk përbën provë konkrete për mosbindje.<sup>104</sup> Fazliu argumenton më tej se deklarata në lidhje me synimet "propozon një mekanizëm garantues të verifikueshëm për të ulur rrezikun dhe siguruar përmbushje efektive.<sup>105</sup> Sipas mendimit të Fazliut, Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të ketë marrë parasysh se çfarë do të ndodhte në qoftë se ai do të shkelte kushtet e lirit.<sup>106</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

38. Në këtë pikë të apelit, Fazliu kundërshton konstatimet e Gjykatës së Procedurës Paraprake në lidhje me: (i) deklaratën në lidhje me synimet e tij;<sup>107</sup> (ii) zotimin e dhënë nga anëtarë të familjes që ofruan garanci financiare në shumë prej

---

<sup>101</sup> Përgjigjja, para. 13.

<sup>102</sup> Përgjigjja, para. 13, që referohet konkretisht Shtojcës 3 të Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatës së Procedurës Paraprake.

<sup>103</sup> Përgjigjja, para. 13.

<sup>104</sup> Kundërpërgjigjja, para. 2. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 3.

<sup>105</sup> Kundërpërgjigjja, para. 4.

<sup>106</sup> Kundërpërgjigjja, para. 4, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Mrkšić*, IT-95-13/1-AR65, Decision on Appeal Against Refusal to Grant Provisional Release, 8 October 2002 ("Vendimi i Apelit në Çështjen Mërkshiq mbi Lirimin e Përkohshëm"), para. 9.

<sup>107</sup> Apeli, para. 32. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para 7-9; Shtojcën 1 të Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatës së Procedurës Paraprake.

40,000 eurosh dhe shtëpinë e tij si garanci shtesë,<sup>108</sup> dhe (iii) një zotim nga djali i tij (së bashku "garancitë").<sup>109</sup>

39. Paneli vëren se, për të mbështetur pretendimin se Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor që hodhi poshtë garancitë që ofroi ai, Fazliu përsërit kryesisht pretendimet që i paraqiti Gjykatësës së Procedurës Paraprake.<sup>110</sup> Duke rikujtuar se pala që pretendon gabim juridik duhet të paraqesë argumente në mbështetje të pretendimit të saj dhe të shpjegojë se si gabimi e bën të pavlefshëm vendimin,<sup>111</sup> Paneli konstaton se Fazliu nuk përmbush këto kushte. Megjithatë, duke pasur parasysh pretendimin e Fazliut se Gjykatësja e Procedurës Paraprake i hodhi poshtë ato bazuar në *interpretim* të gabuar të fakteve që mund të konsiderohen relevante për kryerjen e vlerësimit të rrezikut,<sup>112</sup> dhe për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit, Paneli do të shqyrtojë argumentet e Fazliut që kanë të bëjnë me peshën që u dha garancive Gjykatësja e Procedurës Paraprake.

40. Paneli pajtohet me Fazliun se, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, faktorët që kanë të bëjnë me gjendjen mendore, personalitetin dhe karakterin moral të të akuzuarit janë relevantë për vlerësimin që kryhet sipas nenit 41(6) të Ligjit.<sup>113</sup> Paneli vë në dukje se, në aktgjykimin në çështjen *Maksim Savov v. Bulgaria* në të cilin mbështetet Fazliu,<sup>114</sup> GJEDNJ-ja theksoi se rreziku i arratisjes duhet të vlerësohet duke marrë parasysh faktorët që kanë të bëjnë me personalitetin, karakterin moral, vendbanimin, profesionin, burimet, lidhjet familjare dhe lidhje të tjera me vendin në të cili parashtruesi ndiqet penalisht.<sup>115</sup> Paneli vë në dukje tutje se kjo jurisprudencë e

---

<sup>108</sup> Apeli, para. 34. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, patra 11-9; Shtojcën 2 të Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake.

<sup>109</sup> Apeli, para. 34. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, patra 11-9; Shtojcën 3 të Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake.

<sup>110</sup> Krahaso Apelin, para. 31-32, 34-35, me Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 12, 16-18, 21.

<sup>111</sup> Shih p.sh. Aktgjykimin e Apelit *Mustafa*, para. 18. Shih Aktgjykimin e Apelit *Shala*, para. 28.

<sup>112</sup> Shih Apelin, para. 35 (theksimi i shtuar).

<sup>113</sup> Apeli, para. 33.

<sup>114</sup> Apeli, para. 33-34, poshtëshënimet 44, 46.

<sup>115</sup> *Maksim Savov v. Bulgaria* Judgment, para. 48.

miratuar e GJEDNJ-së,<sup>116</sup> pasqyron kushtet e parapara në nenin 5(3) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("KEDNJ") duke përcaktuar të drejtën për liri dhe siguri dhe që deklaron se lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur për gjykim.<sup>117</sup>

41. Sa i përket detyrimit të gjykatësve për këtë aspekt, Paneli i referohet aktgjykimit në çështjen gjyqësore *Lelièvre v. Belgium* ku mostrajtimi prej autoriteteve i garancive të ofruara nga i akuzuari për t'u paraqitur në gjykim, dhe më përgjithësisht, mosmarrja parasysh e asnjë prej alternativave për paraburgim u konstatua si shkelje e nenit 5(3) të KEDNJ-së.<sup>118</sup> *A contrario*, në kontekst të aktgjykimit në çështjen gjyqësore *Shabani v. Switzerland*, KEDNJ-ja konstatoi se autoritetet nuk gabuan që konstatuan se paraburgimi i parashtruesit ishte përligjur duke pasur parasysh faktin se ai dyshohej se i takonte një organizate kriminale dhe rreziku që ai të arratisë nuk mund të ulej me garancitë që propozoi ai, duke pasur parasysh burimin e dyshimtë të të hollave.<sup>119</sup> Në këtë rast, KEDNJ-ja ishte bindur se garancitë për t'i paraqitur në gjykim u shqyrtuan si duhet dhe nuk u konstatua asnjë shkelje e nenit 5(3) të KEDNJ-së.<sup>120</sup> Paneli arrin në përfundimin se jurisprudenca e GJEDNJ-së, edhe pse gjykatësit duhet të marrin parasysh garancitë për t'u paraqitur në gjykim, ata kanë diskrecion për vendimin se çfarë peshe do t'u japin atyre garancive.

42. Konstatimi i mësipërm është në përputhje me vendimet e mëparshme të Panelit të Gjykatës së Apelit ku përcaktohet se vendimet në lidhje me mbajtjen në paraburgim janë diskrecionale.<sup>121</sup> Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se panelet e shkallës më të ulët

---

<sup>116</sup> Shih ECtHR, *Wemhoff v. Germany*, no. 2122/64, Judgment, 27 June 1968, para. 15. See also ECtHR, *Khudoyorov v. Russia*, no. 6847/02, Judgment, 8 November 2005, para. 183; ECtHR, *Lelièvre v. Belgium*, no. 11287/03, Judgment, 8 November 2007 ("*Lelièvre v. Belgium* Judgment"), para. 97; ECtHR, *Shabani v. Switzerland*, no. 29044/06, Judgment, 5 November 2009 ("*Shabani v. Switzerland* Judgment"), para. 62.

<sup>117</sup> Shih KEDNJ, neni 5(3).

<sup>118</sup> *Lelièvre v. Belgium* Judgment, para. 98, 102, 108.

<sup>119</sup> *Shabani v. Switzerland* Judgment, para. 63.

<sup>120</sup> *Shabani v. Switzerland* Judgment, para. 63.

<sup>121</sup> Shih p.sh. INV/F00273/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 15 maj 2024, (versioni

kanë diskrecionin për të vlerësuar, në kuadër të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, rrethanat që peshojnë në favor ose kundër vazhimit të paraburgimit të një të akuzuari. Për shkak se vendimet mbi lirimin e përkohshëm për nga vetë natyra e tyre lidhen me fakte konkrete, panelet e shkallës më të ulët janë autoritete më të përshtatshme për t'i vlerësuar këta faktorë.<sup>122</sup>

43. Në rastin aktual, kur Gjykatësja e Procedurës Paraprake trajtoi garancitë e Fazliut, ajo konstatoi se: "deklaratën në lidhje me synimet dhe pohimet për reputacion nga ana e të akuzuarit nuk ndryshojnë vlerësimin objektiv se ekziston" rreziku i arratisjet sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit.<sup>123</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake arriti në konstatim të ngjashëm në lidhje me vlerësimin e saj të rrezikut për pengim të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit.<sup>124</sup>

44. Paneli vë në dukje se arsyetimi në Vendimin e Kundërshtuar në lidhje me deklaratën parimore dhe pohimet për reputacion është relativisht i shkurtë. Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk shpjegoi peshën që u dha ajo këtyre parashtrimeve, në qoftë se u ka dhënë, përveç se tregoi që deklarata parimore nga ana e të akuzuarit "nuk ndryshojnë vlerësimin objektiv" të ekzistencës së rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.<sup>125</sup> Megjithatë, duke rikujtuar se një panel duhet të japë arsyet që mbështesin konstatimet e veta mbi aspektet materiale relevante për vendimin, nuk është e nevojshme që ai të sqarojë çdo hap të arsyetimit të vet.<sup>126</sup> Rrjedhimisht, Paneli është bindur se Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka përmbushur detyrimin e vet për shqyrtimin e deklaratës parimore dhe pohimit për reputacion.

---

konfidencial u dorëzua më 13 maj 2024), ("Vendimi i Apelit mbi Lirimin në çështjen *Kilaj 18-01*"), para. 15.

<sup>122</sup> Vendimi i Apelit mbi Lirimin në Çështjen *Kilaj 18-01*, para 15.

<sup>123</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 31.

<sup>124</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 35.

<sup>125</sup> Shih Vendimi i Kundërshtuar, para. 31, 35. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 37.

<sup>126</sup> Shih më lart, para. 16

45. Paneli tani i kthehet argumentit të Fazliut se deklarata në lidhje me synimet "propozon një mekanizëm garantues të verifikueshëm për të ulur rrezikun dhe siguruar përmbushje efektive".<sup>127</sup> Paneli konstaton se Fazliu thjesht nuk pajtohet me peshën që Gjykatësja e Procedurës Paraprake i dha deklaratës në lidhje me synimet e tij dhe nuk tregon se si Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri gabim ose keqpërdori diskrecionin e saj. Paneli vë në dukje se, në deklaratën në lidhje me synimet, Fazliu zotohet se ai, ndër të tjera, do të paraqitet në seanca gjyqësore, përmbush çdo kusht të përcaktuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake dhe nuk do të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve.<sup>128</sup> Paneli vë në dukje se pritjet prej çdo personi që të veprojnë në përputhje me ligjin dhe urdhrat e nxjerra nga gjykata<sup>129</sup>, dhe se moskryerja e veprimeve të ndaluara duhet të jetë normë.<sup>130</sup> Rrjedhimisht, Paneli nuk kupton se si deklarata parimore e Fazliut, në vetvete, do të përbënte "mekanizëm për të ulur rrezikun në mënyrë efektive dhe garantuar respektim", sikurse sugjeron ai. Në kundërshtim me pretendimin e Fazliut, Paneli gjykon se parashtrimet e ZPS-së se pretendimet e tij janë në interes të tij, kanë një lloj baze<sup>131</sup> dhe konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake kishte diskrecion për të vendosur që të mos japë shpjegime të mëtejshme në lidhje me deklaratën në lidhje me synimet ose pohimet për reputacion të Fazliut.

46. Paneli vë në dukje gjithashtu se, për të mbështetur pretendimin e tij se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të kishte trajtuar zbatueshmërinë e deklaratës në lidhje me synimet duke pyetur se çfarë do të ndodhte në qoftë se ai do të shkelte kushtet e lirimit,<sup>132</sup> Fazliu mbështete në një vendim të lëshuar nga Dhoma e Apelit e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë ("TPNJ") në çështjen

---

<sup>127</sup> Kundërpërgjigjja, para. 4.

<sup>128</sup> Shih Shtojcën 1 të Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake.

<sup>129</sup> Shih Aktgjykimin e Apelit *Shala*, para. 916, Shih gjithashtu p.sh. Vendimin e Parë të Apelit të *Kilajt* mbi Paraburgimin, para. 45.

<sup>130</sup> Vendimi i Pestë i Apelit të *Krasniqit* mbi Paraburgimin, para. 27. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Shala*, para. 916.

<sup>131</sup> Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 13.

<sup>132</sup> Shih Kundërpërgjigjen, para. 4.

gjqësore *Mrkšić*.<sup>133</sup> Fillimisht, Paneli rikujton se kryerja e hetimit për të vërtetuar nëse kushtet e lirimit mund të zbatoheshin dhe viheshin në jetë në mënyrë efektive përfshihet në kompetencat diskrecionale që neni 39(13) i Ligjit i jep Gjykatësës së Procedurës Paraprake sa u takon aspekteve të paraburgimit, në varësi të rrethanave të çështjes gjyqësore.<sup>134</sup> Në rrethanat e kësaj çështjeje, moskryerja e një shqyrtimi të tillë nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në lidhje me zotimin e Fazliut nuk përbënte keqpërdorim të diskrecionit.

47. Gjithashtu, Paneli vë në dukje se vendimi i apelit të TPNJ-së në çështjen *Mërkshiq* trajton konkretisht mbështetshmërinë e garancive që japin shtetet dhe çfarë do të ndodhte në qoftë se autoritetet përkatëse do të detyroheshin të arrestonin të akuzuarin sipas garancive që kishin dhënë.<sup>135</sup> Paneli nuk pajtohet se çështja *Mërkshiq* dhe çështja aktuale pasqyrojnë rrethana të ngjashme,<sup>136</sup> dhe konstaton se Vendimi i Apelit në Çështjen *Mërkshiq* mbi Lirimin e Përkohshëm në fakt konfirmon se mbështetshmëria e garancive duhet të vërtetohet në lidhje me rrethanat që lindin në një çështje konkrete.<sup>137</sup> Rrjedhimisht, argumenti Fazliut hidhet poshtë.

---

<sup>133</sup> Shih Kundërpërgjigjen, para. 4, që i referohet Vendimit të Apelit në Çështjen *Mërkshiq* mbi Lirimin e Përkohshëm, para. 9

<sup>134</sup> Shih p.sh. KSC-BC-2020-06, IA015/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 25 mars 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 25 mars 2022), para.22. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, IA007/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para. 56; Vendimi i Parë i Apelit të *Krasniqit* mbi Paraburgimin, para. 56.

<sup>135</sup> Shih Vendimin e Apelit në Çështjen *Mërkshiq* mbi Lirimin e Përkohshëm, para. 9

<sup>136</sup> Paneli vëren se lloji i garancive që u dhanë në këto dy çështje gjyqësore janë shumë të ndryshme. Ndërsa *Mërkshiq* dorëzoi garanci nga shtetet, Fazliu, në anën tjetër, dorëzoi zotime nga ai dhe nga anëtarë të familjes së tij. Shih më lart, para. 38. Paneli vë në dukje më tej se Dhoma e Apelit e TPNJ-së e bëri këtë konstatim në një kontekst shumë konkret, kur shtetet që dhanë garancitë nuk kishin arrestuar dy të akuzuarit e tjerë në çështjen *Mërkshiq*, as "persona të tjerë me pozitë të lartë të akuzuar nga Tribunali". Shih Vendimin e Apelit në Çështjen *Mërkshiq* mbi Lirimin e Përkohshëm, para. 7. Paneli Vëren se në kontekst të këtij vendimi, Dhoma e Apelit konfirmoi vendimin e Dhomës Gjyqësore për të trajtuar me kujdes garancitë e shtetit duke pasur parasysh shqetësimet në lidhje me mbështetshmërinë e tyre dhe konfirmoi më tej se vendimi i Dhomës Gjyqësore për të mos miratuar kërkesën për lirim të përkohshëm të *Mërkshiqit*, para. 7-16.

<sup>137</sup> Shih Vendimin e Apelit në Çështjen *Mërkshiq* mbi Lirimin e Përkohshëm, para. 9.

48. Përgjithësisht, Paneli është bindur se vlerësimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake tregon se ajo i peshoi si duhet garancitë e Fazliut, përfshirë deklaratën parimore kundrejt rreziqeve që evidentoi ajo. Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se kushtet që propozoi Fazliu nuk mund të sigurojnë kontrollimin dhe monitorimin efektiv të komunikimeve të tij. Gjykatësja e Procedurës Paraprake shprehu më tej shqetësime në lidhje me aftësinë, motivin dhe mundësinë e të akuzuarit për të kontaktuar dëshmitarët nëpërmjet djalit të tij dhe bashkëpunëtorëve të tjerë.<sup>138</sup>

49. Së fundi, Paneli vë në dukje se për vlerësimin nëse rreziqet që evidentoi ajo do të mund të uleshin përshtatshëm nga kushtet e propozuara për lirimin e Fazliut, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh garancitë financiare të tij.<sup>139</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se vlerësimi nëse dorëzania mund të shërbejë si një parandalues efektiv duhet të bazohet në dokumentacionin në lidhje me rrethanat financiare të të akuzuarit. Meqenëse Fazliu nuk ka dorëzuar material të tillë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se informacioni shtesë që përfshihet në Shtojcën 2 të Parashtrimeve të Mbrojtjes dorëzuar Gjykatësës së Procedurës Paraprake nuk mund të ndryshojë vlerësimin e saj në lidhje me këtë aspekt.<sup>140</sup> Duke pasur parasysh këtë, Paneli është bindur se Gjykatësja e Procedurës Paraprake i shqyrtoi si duhet garancitë e propozuara nga Fazliu.

50. Sipas mendimit të Panelit, arsyetimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake tregon se ajo shqyrtoi garancitë e Fazliut. Pasi i ka peshuar ato kundrejt faktorëve në favor të vazhdimin të paraburgimit që i kishte rikujtuar,<sup>141</sup> ajo konstatoi se kushtet për lirimin e Fazliut të propozuara më parë nga ai, dhe/ose kushte të arsyeshme shtesë të

---

<sup>138</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 45.

<sup>139</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 44. Shih gjithashtu Shtojcën 2 të Parashtrimeve të Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake.

<sup>140</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 44.

<sup>141</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 26-42.

caktuara nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, vazhdojnë të janë të pamjaftueshme për të ulur rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(i) deri (iii) të Ligjit.<sup>142</sup>

51. Si rezultat, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se Fazliu nuk ka treguar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi ose keqpërdori diskrecionin e saj në lidhje me peshën që ajo u dha garancive. Rrjedhimisht, rrëzohet Pika e Dytë e Apelit të Fazliut.

C. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME "KËMBËNGULJEN DHE GATISHMËRINË" E FAZLIUT PËR TË PENGUAR PROCESIN (PIKA 3)

### 1. Parashtrimet e Palëve

52. Fazliu parashtron se konstatimi i Gjykatës së Procedurës Paraprake në lidhje me "këmbënguljen dhe gatishmërinë" e tij të pretenduar për të penguar procesin e Dhomave të Specializuara, si arsye për vazhdimin e paraburgimit, nuk ka bazë faktike dhe mbështetet vetëm në parashtrimet e mëparshme të lëshuara nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake.<sup>143</sup> Fazliu argumenton se provat në këtë çështje kanë të bëjnë me incidentin e vetëm për të cilin akuzohet në lidhje me një dëshmitar.<sup>144</sup> Fazliu argumenton se këto prova nuk vërtetojnë përsëritje të një gatishmërie të mëhershme që i atribuohet atij dhe se përfundimi i Gjykatës së Procedurës Paraprake është i gabuar.<sup>145</sup>

53. ZPS-ja përgjigjet se Fazliu mbështetet në formulime gjuhësore të nxjerra jashtë konteksti nga Vendimi i Kundërshtuar, dhe nuk vërteton asnjë gabim.<sup>146</sup> Duke u

---

<sup>142</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 47.

<sup>143</sup> Apeli, para. 36, Fazliu parashtron gjithashtu se rreziku që një i akuzuar të pengojë kryerjen e drejtë të procesit nuk mund të mbështetet *in abstracto*; duhet të mbështetet në prova faktike. Shih Apelin, para. 37, që i referohet *Becciev v. Moldova* Judgment, para. 59, duke cituar ECtHR, *Trzaska v. Poland*, no. 25792/94, Judgment, 11 July 2000, para. 65. Fazliu i referohet më tej Shtojcës së Apelit në të cilën ai renditi "fragmentet e përmendura drejtpërdrejt dhe tërthorazi në të cilat mbështetet Vendimi i Kundërshtuar".

<sup>144</sup> Apeli, para. 38.

<sup>145</sup> Apeli, para. 39-40.

<sup>146</sup> Përgjigjja, para. 15, 17.

mbështetur në Vendimin mbi Arrestimin dhe Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, ZPS-ja përgjigjet tutje se këmbëngulja dhe gatishmëria e Fazliut për të penguar procesin rrjedh nga akuzat e konfirmuara në këtë çështje gjyqësore, bazuar në një mori faktesh relevante.<sup>147</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

54. Paneli vëren se, në kontekst të vlerësimit të rrezikut që Fazliu të pengojë procesin e Dhomave të Specializuara, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdojnë të vlejné aspektet e shtjelluara në Vendimin e Katërt të Rishikimit, përfshirë "këmbënguljen dhe gatishmërinë [e Fazliut] për të penguar" procesin duke realizuar interesat dhe urdhrat e udhëheqjes së lartë të UÇK-së.<sup>148</sup>

55. Megjithëse është e vërtetë në fakt se referencat e kundërshtuara mbështeten në konstatime të mëparshme të Gjykatësës së Procedurës Paraprake,<sup>149</sup> Paneli hedh poshtë pretendimet e Fazliut për gabime për arsyet në vijim.

56. Paneli vë në dukje se Gjykatësja e Procedurës Paraprake iu referua "gatishmërisë" së Fazliut për të vijuar përpjekjet për pengim në lidhje me konstatimin se saj se pretendohet që Fazliu u përshi në sjellje për të cilën akuzohet në Aktakuzë me dijeninë se kjo sjellje tentonte të pengonte procesin e Dhomave të Specializuara dhe se përkundër asaj vijoi me ato veprime.<sup>150</sup> Rrjedhimisht, duke pasur parasysh kontekstin në të cilin kjo u përmend për herë të parë nga Gjykatësja e Procedurës

---

<sup>147</sup> Përgjigjja, para. 16.

<sup>148</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 34.

<sup>149</sup> Apeli, para. 36, që i referohet Shtojcës së Apelit ku Fazliu parashtroi se ai renditi "fragmentet e përmendura drejtpërdrejt dhe tërthorazi në të cilat mbështetet Vendimi i Kundërshtuar". Shih Apelin, para. 37. Paneli vë në dukje se Gjykatësja e Procedurës Paraprake iu referua këmbënguljes së pretenduar të Fazliut për të realizuar përpjekjet për pengim për herë të parë në kontekst të Vendimit mbi Arrestimin. Shih Vendimin mbi Arrestimin, para. 86. Sa i takon gatishmërisë së pretenduar të Fazliut për të penguar procesin, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arriti në këtë konstatim për herë të parë në kontekst të Vendimit të Parë të Rishikimit. Shih Vendimin e Parë të Rishikimit, para. 24. Të dy referencat u përsëritën në vendime të mëpasshme në të cilat u vazhdua paraburgimi i Fazliut. Shih Vendimin e Dytë të Rishikimit, para. 38; Vendimin e Tretë të Rishikimit, para. 27; Vendimin e Katërt të Rishikimit, para. 16. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 34.

<sup>150</sup> Vendimi mbi Arrestimin, para. 86.

Paraprake,<sup>151</sup> Paneli kupton se referenca ndaj "gatishmërisë" nuk interpretohet si "përsëritje" e një veprimi sikurse pretendon Fazliu,<sup>152</sup> por si "vazhdim i një veprimi përkundër dijenisë për llojin e tij". Gjithashtu, ky interpretim përputhet me formulimet në Aktakuzë, ku të akuzuarit akuzohen për pjesëmarrje në grup që synonte të ndikonte në mënyrë të paligjshme në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*.<sup>153</sup>

57. Sa i përket referencës ndaj gatishmërisë së pretenduar të Fazliut për të penguar procesin<sup>154</sup>, një rishikim i vendimeve të mëparshme të Gjykatësës së Procedurës Paraprake<sup>155</sup> tregon se ajo iu referua asaj në kontekst të vlerësimit të rrezikut të pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit.<sup>156</sup> Sipas mendimit të Panelit, "gatishmëria" duhet të kuptohet si "predispozitë" [për të frikësuar dëshmitarë]. Sa i takon pretendimit të Fazliut se nuk ka prova që vërtetojnë gatishmëri ose gjasë që i atribuohet atij,<sup>157</sup> Paneli konstaton se ishte a arsyeshme që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të mbante parasysh se Fazliu ka predispozitë ose prirje për të frikësuar dëshmitarë duke pasur parasysh konstatimet e tjera të saj se ekziston dyshimi i bazuar se ai nxori informacion konfidencial për palë të treta të paautorizuara.<sup>158</sup> Paneli thekson se vet lloji konkret i akuzave të konfirmuara është faktor relevant që Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh për vlerësimin e ekzistencës së

---

<sup>151</sup> Vendimi mbi Arrestimin, para. 86.

<sup>152</sup> Apeli, para. 39.

<sup>153</sup> Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar, para. 8, 45, 49, 51.

<sup>154</sup> Apeli, para. 36.

<sup>155</sup> Vendimi i Parë i Rishikimit, para. 24, që i referohet Vendimit mbi Arrestimin, para 86.

<sup>156</sup> Vendimi i Parë i Rishikimit, para. 24-27.

<sup>157</sup> Apeli, para. 39.

<sup>158</sup> Shih Vendimin e Konfirmimit, para. 42-43; Vendimin mbi Arrestimin, para. 43. Shih gjithashtu Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 53.

rrezikut të pengimit të procesit.<sup>159</sup> Gjithashtu, dhe sikurse është thënë më parë,<sup>160</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake vetëm u bazua në gatishmërinë e pretenduar të Fazliut dhe prirjen për të penguar procesin si një nga shumë faktorë për të mbështetur konstatimin e saj se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit.<sup>161</sup> Rrjedhimisht, Fazliu nuk tregon se nuk ishte e arsyeshme që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të arrinte në ato deduktime.<sup>162</sup>

58. Së fundi, Paneli pajtohet me mendimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake se kundërshtimi i Fazliut ndaj gatishmërisë dhe prirjes së tij të pretenduar për të penguar procesin është në fakt kundërshtim i provave.<sup>163</sup> Për të mbështetur këtë argument, Fazliu bazohet në atë që ai konsideron "të vetmen provë konkrete" që mbështet konstatimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake.<sup>164</sup> Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se cilësia dhe fuqia e provave të ZPS-së janë aspekte që diskutohen në gjykim dhe se vendimi aktual në lidhje me paraburgimin nuk është forumi i duhur për trajtimin e këtij argumenti.<sup>165</sup> Rrjedhimisht, Paneli nuk do të trajtojë argumentin e Fazliut se provat në këtë çështje gjyqësore kanë të bëjnë me incidentin e vetëm për të

---

<sup>159</sup> Vendimi i Dytë i Apelit të *Kilajt* mbi Paraburgimin, para. 71. Shih, gjithashtu KSC-BC-2020-07, IA007/F00004 dhe IA008/F00004, Vendim Përmbledhës mbi Apelet e Nasim Haradinajt kundër Vendimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit, 6 prill 2022 ("Vendimi Përmbledhës i Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*"), para. 45. Paneli rikujton gjithashtu se në kuadër të rishikimit të paraburgimit, Fazliu nuk kundërshtoi ekzistencën e dyshimit të bazuar. Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para.8.

<sup>160</sup> Shih më lart, para. 54.

<sup>161</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 34.

<sup>162</sup> Shih Apelin, para. 39.

<sup>163</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 35.

<sup>164</sup> Apeli, para. 38. Paneli thekson se ZPS-ja përgjigjet duke u bazuar në "mori të faktorëve relevantë" që ka paraqitur për të mbështetur akuzat e konfirmuara në këtë çështje gjyqësore. Shih Përgjigjen, para. 16, që i referohet përgjithësisht Vendimit mbi Arrestimin dhe Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar.

<sup>165</sup> Vendimi i Dytë i Apelit të *Kilajt* mbi Paraburgimit, para. 36. Shih gjithashtu Vendimin e Dytë të Apelit të *Veselit* mbi Paraburgimin, para. 23; KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 27 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 27 tetor 2021) ("Vendimi i Dytë i Apelit të *Thaçit* mbi Paraburgimin"), para. 40-16.

cilin akuzohet ai, në lidhje me një dëshmitar,<sup>166</sup> si dhe argumentin përkatës të ZPS-së që bazohet në akuzat e paraqitura në Aktakuzë.<sup>167</sup>

59. Si rezultat, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se Fazliu nuk ka treguar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi ose keqpërdori diskrecionin që iu referua gatishmërisë ose prirjes së tij të pretenduar për të penguar procesin e Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, rrëzohet Pika e Tretë e Apelit të Fazliut.

D. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME DIJENINË NË RITJE TË FAZLIUT PËR AKUZAT DHE PROVAT (PIKA 4)

### 1. Parashtrimet e Palëve

60. Fazliu parashtron se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që u mbështet në dijeninë e tij në rritje për akuzat kundër tij dhe provat e çështjes për të konstatuar se kjo e rrit rrezikun e arratisjes, pengimit dhe përsëritjes së veprës penale.<sup>168</sup> Duke cekur se nxjerrja e provave për të akuzuarin është "themel i drejtësisë procedurale" dhe se është thelbësore për përgatitjen e një mbrojtjeje efektive, Fazliu argumenton se thjesht ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund të trajtohet në mënyrë legjitime si rrezik në vetvete ose se mund të shkaktojë prezumim të rrezikut.<sup>169</sup>

61. Fazliu parashtron gjithashtu se është e gabuar mbështetja e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në thjesht njoftimin për prova për vlerësimin e rrezikut sipas nenit 41(6) të Ligjit, pa ndonjë tregues të faktuar se i akuzuari i përdori paligjshëm ato.<sup>170</sup> Sipas Fazliut, kjo situatë do të çonte në "përfundim të palogjikshëm dhe absurd" se i akuzuari mund të lirohet vetëm para se të nxirren provat.<sup>171</sup>

---

<sup>166</sup> Apeli, para. 38.

<sup>167</sup> Përgjigjja, para. 16.

<sup>168</sup> Apeli, para. 41-44.

<sup>169</sup> Apeli, para. 42.

<sup>170</sup> Apeli, para. 43.

<sup>171</sup> Apeli, para. 43.

62. ZPS-ja përgjigjet se Fazliu nuk vërteton asnjë gabim në vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6) të Ligjit të kryer në Vendimin e Kundërshtuar.<sup>172</sup> Ajo argumenton se pretendimi i Fazliut për mbështetje të pavend në nxjerrjen në vijimësi të materialit të ZPS-së kundërshtohet nga jurisprudenca që konfirmon se ky është një faktor diskrecional relevant për vlerësimin e ekzistencës së rrezikut të pengimit.<sup>173</sup> ZPS-ja parashtron më tej se Fazliu nuk i kushton vëmendje konstatimit se ky është një aspekt relevant për motivin e tij për t'u arratisur. Sipas mendimit të ZPS-së, Fazliu shpërfill se ky ishte një faktorë "ndër shumë të tjerë" që Gjykatësja e Procedurës Paraprake i mbajti parasysh për vlerësimin e rreziqeve.<sup>174</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

63. Paneli do të shqyrtojë së pari argumentin e Fazliut se thjesht ushtrimi i të drejtës së tij për nxjerrje të materialit nuk duhet të trajtohet si rrezik në vetvete.<sup>175</sup>

64. Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton rëndësinë e procesit të nxjerrjes së materialit për garantimin e drejtësisë së procesit dhe të respektimit të të drejtave të Mbrojtjes, dhe se kjo duhet të mbetet me rëndësi parësore.<sup>176</sup> Në këtë kuptim, Paneli pajtohet me Fazliun se nxjerrja e materialit për të akuzuarin nga ZPS-ja në kuadër të procesit gjyqësor është një hap procedural i detyrueshëm që është thelbësor për përgatitjen e mbrojtjes.<sup>177</sup>

---

<sup>172</sup> Përgjigjja, para. 20. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 21.

<sup>173</sup> Përgjigjja, para. 18-19.

<sup>174</sup> Përgjigjja, para. 19.

<sup>175</sup> Shih Apelin, para. 42.

<sup>176</sup> Shih SC-CA-2022-01, F00044/RED Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Njoftimet e Prokurorisë, 31 janar 2023, (versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 15 shtator 2022, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 26 shtator 2022); para. 20. KSC-CA-2024-03, F00028, Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Zgjatje të Afatit për Dorëzim të Dosjes së Apelit, 21 nëntor 2024 (konfidencial, u riklasifikua si publik më 25 nëntor 2024), para. 15. KSC-CA-2024-03, F00034/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Nxjerrjen e Materialit (versioni konfidencial u dorëzua më 10 janar 2025), para. 11.

<sup>177</sup> Shih rregullën 102 të Rregullores. Në lidhje me këtë, Panelit thekson megjithatë se jurisprudenca e GJEDNJ-së që përmend Fazliu i referohet në fakt të drejtës së të akuzuarit për t'u informuar në lidhje me bazën faktike dhe ligjore për akuzat kundër tij, e jo të drejtës për qasje në vet prova. Shih Apelin,

65. Sidoqoftë, Paneli rikujton se qasja e të akuzuarit në prova të ZPS-së dhe dijenia në rritje për to përmes procesit të nxjerrjes së materialit, marrë së bashku me faktorë të tjerë, mund të jetë faktor relevant për të vërtetuar ekzistencën e rrezikut të pengimit,<sup>178</sup> dhe rrit aftësinë për të penguar procesin, pasi të akuzuarit i vihet në dispozicion informacion më i hollësishëm.<sup>179</sup> Megjithatë, Paneli mban parasysh gjithashtu se ky është vetëm një faktor që duhet të merret parasysh kur vendoset nëse vazhdimi i paraburgimit duket i domosdoshëm, dhe nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arsyetuar refuzimin e lirit të përkohshëm.<sup>180</sup>

66. Në rrethanat aktuale, dhe duke pasur parasysh faktorët në të cilët u mbështet Gjykatësja e Procedurës Paraprake,<sup>181</sup> Paneli i Apelit konstaton se në diskrecionin e

---

para. 42, poshtëshënimi. 56, që i referohet ECtHR, *Pélissier and Sassi v. France*, no. 25444/94, Judgment, 25 March 1999, para. 54; ECtHR, *Dallos v. Hungary*, no. 29082/95, Judgment, 1 March 2001, para. 47.

<sup>178</sup> Shih p.sh. Vendimin e Parë të Apelit të *Kilajt* mbi Paraburgimin, para. 44. Shih gjithashtu Vendimin e Dytë të Apelit të *Kilajt* mbi Paraburgimin, para. 80; Vendimi i Pestë i Apelit të *Selimit* mbi Paraburgimin, para. 30; Vendimi i Pestë i Apelit të *Krasniqit* mbi Paraburgimin, para. 43.

<sup>179</sup> Shih Vendimin e Dytë të Apelit të *Kilajt* mbi Paraburgimin, para. 80; Vendimi i Dytë i Apelit të *Thaçit* mbi Paraburgimin, para. 40.

<sup>180</sup> Shih, Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 30; Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Krasniqit*, para. 43. Shih gjithashtu Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Kilajt*, para. 80.

<sup>181</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 26,34. Paneli kujton se, për rrezikun e arratisjes, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh faktorët në vijim: (i) dijeninë e Fazliut për peshën e veprave penale për të cilat akuzohet, së bashku me dënimin e mundshëm me të cilin mund të dënohet për to, në qoftë se shpallet fajtor; (ii) shpërfillja e tij e hapur për ligjet dhe rregullat e Dhomave të Specializuara (iii) faktin që Fazliu ka mundësi të arratiset, duke udhëtuar lirisht në juridiksione ku nuk mund të kapet nga Dhomat e Specializuara; (iv) faktin që ai gjithashtu ka mjete t'i ikë drejtësisë, duke pasur parasysh karrierën e gjatë politike në Kosovë dhe lidhjet e ngushta me ish-komandantë të UÇK-së, përfshirë veteranët e UÇK-së me ndikim politik – midis tyre Thaçin – prej të cilit mund të kërkojë dhe marrë burime dhe mbështetje për arratisje; dhe (v) faktin që, prej arrestimit, Fazliu ka njohuri për provat në mbështetje të aktakuzës kundër tij, dhe po informohet vazhdimisht – përmes nxjerrjes së materialit – për të gjitha provat e çështjes për veprat e tij penale. Sa i përket rrezikut të pengimit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh: (i) llojin e akuzave të konfirmuara kundër Fazliut, i cili ishte pjesë a grupit, të udhëhequr nga Thaçi, që kishte për qëllim ndikimin e paligjshëm të dëshmitarëve; (ii) dijenia e treguar e Fazliut për synimet penguese të Thaçit, dhe synimit të tij për t'i arritur ato; (iii) këmbëngulësinë dhe gatishmërinë e tij për të penguar procesin para Dhomave të Specializuara duke i arritur interesat dhe urdhrat e udhëheqjes së lartë të UÇK-së; (iv) aftësinë e tij për të marrë pajtueshmërinë prej njerëzve besnikë, përfshirë djalin e tij, për të penguar procesin e Dhomave të Specializuara; (v) dijeninë e tij në rritje për provat fajësuese kundër tij; dhe (vi) atmosferën e frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të Dhomave të Specializuara. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 26, 34, 38.

Gjykatëses së Procedurës Paraprake përfshihej edhe mbështetja në procesin në vijimësi të nxjerrjes së materialit dhe në dijeninë në rritje të Fazliut për provat inkriminuese kundër tij.<sup>182</sup>

67. Po kështu, Paneli nuk bindet nga pretendimi hamendësues i Fazliut, sipas të cilit në qoftë se zbatohet arsyetimi në Vendimin e Kundërshtuar, atëherë të gjithë të akuzuarit do të liroheshin "vetëm para nxjerrjes së materialit".<sup>183</sup> Së pari, nxjerrja e materialit është vetëm një ndër shumë faktorë të tjerë në të cilët u mbështet Gjykatësja e Procedurës Paraprake.<sup>184</sup> Së dyti, sikurse u përmend më lart, nxjerrja e materialit në vetvete është e pamjaftueshme për të refuzuar lirimin e përkohshëm.<sup>185</sup>

68. Duke iu kthyer pretendimit të Fazliut se nuk ka tregues që ai ka përdorur ndonjëherë paligjshëm provat në të cilat ka qasje,<sup>186</sup> Paneli rikujton së pari se standardi për vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit nuk kërkon që të vërtetohet se Fazliu ka frikësuar dëshmitarë ose ka ndërhyrë te ta ose se *do ta* bëjë këtë.<sup>187</sup> Paneli thekson se për përcaktimin e domosdoshmërisë së mbajtjes në paraburgim pyetja që ngrihet ka të bëjë me mundësinë, jo me pashmangshmërinë e një ngjarjeje në të ardhmen,<sup>188</sup> dhe se neni 41(6)(b) i Ligjit nuk kërkon që të vërtetohet se në të shkuarën pengimi ka ndodhur realisht.<sup>189</sup> Rrjedhimisht, sugjerimi i Fazliut se nuk ka prova se ai ka përdorur këto prova paligjshëm është jorelevant në kuadër të këtij vendimi.<sup>190</sup>

---

<sup>182</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 26,34.

<sup>183</sup> Shih Apelin, para. 43.

<sup>184</sup> Shih më lart, poshtëshënimin 181.

<sup>185</sup> Shih më lart, para. 65.

<sup>186</sup> Shih Apelin, para. 43.

<sup>187</sup> Shih Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 53; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Kilajt*, para. 70.

<sup>188</sup> Shih, Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit* para. 38; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Kilajt*, para. 70; Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e *Gucatit*, para. 67. Shih Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 19

<sup>189</sup> Shih Vendimi i Parë i Apelit të *Veselit* mbi Paraburgimin, para. 38; Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e *Kilajt*, para. 70.

<sup>190</sup> Shih p.sh., Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Kilajt*, para. 70; Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Kilajt*, para. 43. Shih gjithashtu Vendimin Përmbledhës të Apelit mbi Paraburgimin

69. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Fazliu nuk ka vërtetuar asnjë gabim që Gjykatësja e Procedurës Paraprake u mbështet në dijeninë e tij në rritje për akuzat kundër tij dhe dijeninë për provat për të vlerësuar rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.<sup>191</sup> Rrjedhimisht, Paneli e rrëzon Pikën e Katërt të Apelit të Fazliut.

## V. VENDIM

70. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit:

**RRËZON** apelin në tërësinë e tij;

**MIRATON** Kërkesën për riklasifikim;

**URDHËRON** që Apeli (IA008/F00001), Përgjigjja (IA008/F00003), Kundërpërgjigjja (IA008/F00005) dhe Kërkesa për Riklasifikim (IA008/F00004) të riklasifikohen si publike në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores;<sup>192</sup> dhe

**UDHËZON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publik parashtrimet e lartpërmendura.

---

e *Haradinajt*, para. 44. Paneli vëren se rrethanat e kësaj çështje dallojnë nga çështja gjyqësore *Stanishiq dhe Simatoviq* sepse të akuzuarit në atë rast janë liruar përkohshëm më parë. Shih Apelin, poshtëshënimin 58, që i referohet ICTY, *Stanišić and Simatović*, IT-03-69-AR56.4, Decision on Prosecution Appeal of Decision on Provisional Release and Motions to Present Additional Evidence Pursuant to Rule 115, 26 June 2008, para. 55.

<sup>191</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 26, 30, 34. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 40.

<sup>192</sup> Riklasifikimi nuk vlen për Shtojcën e Apelit, që vazhdon të jetë konfidenciale. Shih më lart, para.9, poshtëshënimi 27.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar**

**Kryegjykatëse**

E premte, 5 dhjetor 2025

Hagë, Holandë